



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 56 prot.

Kamëz, më 18.7.2025

V E N D I M
Nr. 48. Datë 18/7 2025
MBI

“PËRFUNDIMIN E TRAJTIMIT ME BONUSIN E QIRASË PËR FAMILJET, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.07.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.44 Datë 16.07.2025 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 8, datë 7.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ nr. 37 datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime të aktit normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, nenit 26, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, VKB nr.119 datë 19.12.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2025-2027”, shkresës nr.6056 Prot, datë 11.07.2025, shkresës me nr. 5319/1 Prot datë 26.06.2025, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përfundimit të trajtimit me bonusin e qirasë për familjet , banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas relacionit pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare për përfundimin e trajtimit me bonusin e qirasë për familjet e përmendura në pikën 1 do të fillojnë nga muaji Gusht 2025.
3. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLBASHI

